

PYETJET E HISTORISE SE ARTIT

Departamenti i Pikturës

Pyetjet janë të ndara në numra rendor dhe çdo numër përmban tre nënpyetje:

a - Nga historia e artit botëror

b – Nga historia e artit shqiptar

c - Nga specialiteti i zgjedhur

Pyetjet shërbejnë për njërën nga fazat e konkursit të pranimit të studentëve në Universitetin e Arteve, Fakulteti i Arteve të Bukura. Krahas konkurimit praktik në pikturë, skulpturë dhe vizatim, studenti testohet edhe teorikisht për njohuritë e tij rreth Historisë së Artit botëror, Historisë së Artit Shqiptar me specifikisht mbi specialitetin e përzgjedhur.

Pyetjet shërbejnë si një orientim fillestar në bashkëbisedim. Anëtarët e komisionit kanë të drejtë të bëjnë dhe pyetje shtesë kur ata e shohin të nevojshme.

Secili student tërheq tezën me pyetjet dhe përgjigjet në prani të komisionit. Studenti ka të drejtë të tërheqë pyetjet deri në dy herë.

...

PYETJET PËR ATELIERIN E PIKTURËS SË KAVALETIT

Teza 1

- a) Historia e Artit ndahet në periudha. Përmendni si ndryshoi ai nga Antikiteti në Mesjetë dhe më pas në Rilindje.
- b) Flisni mbi jetën dhe veprën e piktorit Zef Kolombi. Komentoni mbi ndonjë vepër të njohur të tij.
- c) Flisni mbi marrëdhënien e fotografisë me pikturën dhe anasjelltas. A kanë pasur këto medime shkëmbime mes tyre.

Teza 2

- a) Flisni mbi Egjiptin e lashtë dhe karakteristikat e artit në këtë periudhë? Për sa kohë zgjati ai dhe kë kulturë ndikoi?
- b) Çfarë mund të thoni mbi krijimtarinë artistike të piktorit Abdurrahim Buza? Cila është tema qendrore e tij? Merrni e komentoni një vepër të tij.
- c) Çfarë dini mbi pikturën digjitale? Çfarë mangësish e përparësish mund të ketë ajo në marrëdhënie me pikturën tradicionale?

Teza 3

- a) Flisni për artin në periudhën e Barokut. Ku u shtri ai dhe çfarë karakteristikash pati? Flisni më gjatë për një artist të kësaj periudhe.
- b) Kur u shfaq metoda e “Realizmit Socialist” në Shqipëri? Çfarë tiparesh shfaqte kjo metodë? Komentoni ndonjë vepër tipike të Realizmit socialist shqiptar.
- c) Përmendi pesë piktorë bashkohorë shqiptar. Flisni më gjatë për njërin prej tyre.

Teza 4

a) Flisni mbi temën, formën dhe funksionin e artit religjuz. Përshkruani kohën kur arti religjuz ishte dominues në artin Perëndimor.

b) Çfarë mund të thoni mbi piktorin Vangjush Mio. Cila është gjinia artistike ku spikat më tepër personaliteti i tij? Komentoni një vepër të tij.

c) Kush është piktori Gerhard Rihter? Flisni më shumë mbi krijimtarinë e tij.

Teza 5

a) Flisni çfarë dini mbi qytetërimin dhe artin grek. Komentoni mbi disa vepra të rëndësishme greke në arkitekturë dhe skulpturë dhe tiparet e tyre.

b) Kush është piktori Sali Shijaku? Përmendini disa nga veprat e tij dhe flisni më gjatë për një të prej tyre.

c) Çfarë është teknika sfumatos? Kush e përdori atë dhe për të arritur çfarë rezultatesh?

Teza 6

a) Flisni mbi Rilindjen Italiane, fazat e zhvillimit të saj dhe autorët përfaqësues. Analizoni një vepër të njohur të Rilindjes.

b) Flisni mbi Onufrin. Kush ishte ai dhe kur jetoi. A mund të citoni një muze të Shqipërisë ku ruhen dhe ekspozohen koleksione ikonash?

c) Çfarë dini mbi teknikën e kolazhit? A mund të gjeni një vepër ku është përdorur?

Teza 7

- a) Flisni për Davidin e Mikelanxhelos? Prej nga është marrë tema e kësaj vepre dhe çfarë trajton ajo? Përmendni disa vepra të tjera të këtij autori.
- b) Flisni mbi nisjen dhe zhvillimin e pikturës realiste në Shqipëri. Kush ishte protagonist i saj në fund shek. XIX.
- c) Çfarë dini mbi teknikën e pastelit dhe cilësitë dhe rezultatet e tij në krahasim me teknikat e tjera?

Teza 8

- a) Flisni për artistin gjerman Albert Durer, kur jetoi ai dhe çfarë risish solli? Përmendni ndonjë vepër të rëndësishme të tij.
- b) Cilët janë fotografët Marubi dhe vlera e punës së tyre.
- c) Çfarë dini mbi teknikën piktorike të akuarelit dhe cilësitë e saj në krahasim me teknikat e tjera?

Teza 9

- a) Flisni mbi çka dini rreth jetës dhe krijimtarisë së piktorit Caravaggio. Analizoni një vepër të tij.
- b) Citoni disa vepra të piktorit Kolë Idromeno dhe komentoni atë ju ka lënë më shumë mbresë.
- c) Përshkruani disa mënyra pikturimi brenda teknikës së ngjyrave të vajit (pastoze, velatura, etj) duke e konkretizuar këtë gjë në veprën e piktorëve të ndryshëm.

Teza 10

- a) Përmendni disa nga veprat më të rëndësishme të piktorit Diego Velasques. Çfarë ju bën përshtypje në veprën e tij? Komentoni mbi një vepër të tij.
- b) Cilët janë autorët e monumentit të “Skënderbeu mbi kalë”, në qendër të Tiranës. Flisni për kohën dhe kushtet kur u realizua ajo.
- c) A mund të flisni për ndryshimet që ka pësuar në përmbajtje dhe në formë arti pas periudhës së viteve ‘90 e deri më sot në krahasim me artin e periudhës së komunizmit?

Teza 11

- a) Cilat janë temat që trajtuan piktorët e Realizmit Francez? Në çfarë kushtet lindën këto vepra? Përmendni disa prej tyre.
- b) Kujt periudhe i takon “Epitafi i Gllavenicës” dhe në cilin muze ruhet sot? A mund ta përshkruani këtë vepër?
- c) Flisni mbi teknikën piktorike të ngjyrave të vajit dhe cilësitë e saj në krahasim me teknikat e tjera.

Teza 12

- a) Çfarë dini mbi Impresionizmin? Përmendni përfaqësuesit e tij dhe flisni gjerësisht mbi jetën dhe veprën e njërit prej tyre.
- b) Citoni disa vepra të piktorit pasbizantin David Selenica. Flisni për periudhën kur ai jetoi dhe krijoi.
- c) Flisni çfarë dini mbi teknikën e Neoimpresionizmit të quajtur puantilizëm (pointillisme). Si realizohej kjo teknikë piktorike dhe me çfarë synimesh dhe rezultatesh?

Teza 13

- a) Çfarë përfaqson Kubizmi? Citoni emrat e dy piktorëve kubistë. Cila është vepra e parë që zyrtarisht u etiketua kubiste?
- b) Citoni disa vepra të piktorit Guri Madhi dhe analizoni njerën prej tyre.
- c) Flisni mbi një ekspozitë të arteve pamore që ke vizituar në Shqipëri. Flisni gjerësisht rreth saj.

Teza 14

- a) Flisni mbi Ekspresionizmin abstrakt duke përmenduar disa nga protagonistët.
- b) Çfarë dini rreth fotografit Gjon Mili? Ku u zhvillua vepra e tij dhe çfarë risish kishte ajo për kohën?
- c) Çfarë dini mbi teknikën piktorike të temperas dhe cilësitë e saj në krahasim me teknikat e tjera?

Teza 15

- a) Flisni çfarë dini mbi platformat e Artit Minimal si dhe Konceptual. Çfarë ndryshoi në statusin e veprës së artit?
- b) Çfarë dini mbi piktorin Sadik Kaceli. Cilës periudhë i përket ai dhe çfarë temash trajtoi?
- c) Flisni mbi elementet e pikturës dekorative dhe asaj natyraliste.

Bibliografi

- Ernst H. Gombrich, **Historia e Artit**, (1996).
- Ermir Hoxha, **Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000**, (2019)
- Ermir Hoxha, **Historia e Artit në Shqipëri nga Prehistoria në Shek XIX**, (2020)
- Rozela Dhimgjini, **Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX**, (2016).
- **Internet**: List of art movements.

PYETJET PËR ATELIERIN E PIKTURËS MONUMENTALE

Teza 1

- a) Çfarë dini mbi artin prehistorik, funksionin e tij dhe karakteristikat që mbart?
- b) Flisni mbi jetën dhe veprën e Kol Idromenos. Analizoni e komentoni pikturën e tij “Motra Tone”.
- c) Çfarë qëllimi pati piktura monumentale në arkitekturën religjose? Përmendni një autor përfaqësues të saj?

Teza 2

- a) Përmendni disa nga veprat artistike më të rëndësishme të artit klasik Grek, në arkitekturë e skulpturë. Pse u quajt “Klasike” dhe në ç’periudha të tjera të mëvonshme pati ndikim te dukshëm?
- b) Flisni mbi përmbajtjen dhe stilin e mozaikut në fasadën e “Muzeut Historik Kombëtar” në Tiranë? Cilët janë autorët e saj?
- c) Çfarë dini mbi teknikën e vitrazhit? Si lidhet kjo teknikë me arkitekturën?

Teza 3

- a) Citoni disa nga dëshmitë më të rëndësishme artistike të artit Romak, në arkitekturë, skulpturë, pikturë. Ndaluni e komentoni më gjerësisht një të një prej tyre.
- b) Flisni për piktorin Edison Gjergo dhe marrëdhënien e tij me rregjimin komunist? Flisni mbi një vepër të tij përfaqësuese.
- c) Flisni mbi një vepër të pikturës murale në Shqipëri. Ku ndodhet ajo dhe në ç’kushte është realizuar?

Teza 4

- a) Cili ishte piktori i famshëm Van Gog? Cilës periudhë të artit i përket ai? Flisni më gjatë për stilin e tij piktorik.
- b) Çfarë dini mbi piktorin Vangjush Mio dhe veprën e tij? Komentoni një vepër të tijën.
- D) Çfarë është afresku? Çfarë dini mbi teknikën dhe procedurën e realizmit të tij?

Teza 5

- a) Një periudhë në historinë e artit u quajt “Rilindje”. Pse u quajt kështu? Ku lindi fillimisht dhe ku u shfaq më pas ajo?
- b) Flisni mbi një artist bashkëkohor shqiptar që njihni. Analizoni ndonjë prej veprave të tij.
- c) Çfarë është mozaiku? Çfarë dini mbi teknikën dhe procedurën e realizmit të tij?

Teza 6

- a) Kush është autori i pikturës murale “Darka e fundit”? Ku ndodhet ajo? Prej nga është marrë tema e kësaj vepre dhe çfarë trajton ajo? Përmendni disa vepra të rëndësishme të këtij autori.
- b) Flisni mbi piktorin Sadik Kaceli. Komentoni mbi një vepër të tij.
- c) Flisni mbi pikturën aseko dhe teknikat e realizmit të tij.

Teza 7

- a) Kush është autori i pikturës murale “*Shkolla e Athinës*”? Ku ndodhet kjo vepër? Çfarë trajtohet në këtë vepër? Përmendni disa vepra të rëndësishme të këtij autori.
- b) Flisni për pikturën murale të Bashkim Ahmetit në Muzeun e Krujës. Kur u realizua ajo dhe në çfarë kushtesh historike.
- c) Flisni mbi teknikat e pikturës romake. Përshkruani përmbajtjen dhe stilin e pikturës pompeiane të gjendur në vilat e qytetit Pompei.

Teza 8

- a) Përmendni disa nga veprat më të rëndësishme të Rembrandit. Çfarë e bën të dallueshme veprën e Rembrandit? Komentoni shkurt rreth jetës së tij.
- b) Cili është autori i tablosë “*Dasma Shkodrane*”? Analizoni këtë vepër? Citoni një vepër tjetër po të këtij autori.
- c) Çfarë dini mbi artin në hapësirën publike? Në çfarë konsiston ai? Përmendi një vepër të kësaj gjinie.

Teza 9

- a) Citoni emrat e disa piktorëve të shquar spanjollë. Flisni më gjerë për njërin prej tyre.
- b) Citoni disa autorët shqiptarë që kanë trajtuar teknikën e afreskut në muzetë e vendit tonë?
- c) Flisni mbi një muze apo galeri që keni vizituar. Si ishin realizuar interieri në to?

Teza 10

- a) Flisni mbi prirjet dhe autorët e Neoklasicizmit. Cili është autori i tabllësë “Marati i vrarë”? Flisni mbi të ose mbi ndonjë vepër tjetër të tij.
- b) Citoni tre ikonografë të shquar Shqiptarë. Citoni disa muze ku ruhen vepra të artit ikonografik.
- c) Përmendni disa nga teknikat e pikturës monumentale.

Teza 11

- a) Përmendni disa vepra të artistëve të Rilindjes italiane që njihni. Përshkruani një të njërën prej tyre.
- a) Analizoni krijimtarinë e artistit Sali Shijaku. Komentoni ndonjë vepër të njohur të tij.
- b) Flisni rreth tipareve të teknikës së afreskut në aspektet e destinacionit, përmbajtjes dhe formës si stil e teknikë.

Teza 12

- a) Përse Impresionizmi konsiderohet një dukuri e rëndësishme në historinë e artit? Pse u quajt Impresionizëm? Citoni emrat e tre autorëve impresionistë.
- b) Citoni një amfiteatër që gjendet në Shqipëri. Si ishte i ndërtuar dhe përse shërbente një amfiteatër?
- c) Çfarë është instalacioni? A mund ta përshkruani se si dhe me çfarë operon ky medium?

Teza 13

- a) Flisni mbi pararojat artistike të shekullit të njëzetë. Ndaluni më hollësisht në një të njërën syresh (Abstraksiozmi, Kubizmi, Futurizmi).
- b) A mund të flisni mbi mozaikun “Bukuroshja e Durrësit”? Ku gjendet ai sot?
- c) Flisni mbi krijimtarinë e piktorit Danish Jukniu ose të ndonjë bashkëkohësi të tij.

Teza 14

- a) Flisni çfarë dini mbi Surrealizmin? Kush ishte përfaqësuesi më i spikatur i kësaj rryme? Përmendni titujt e ndonjë vepre të tij dhe analizoni atë.
- b) Citoni emrin e një piktori anglez që ka udhëtar në Shqipëri dhe ka pikturuar peizazhin shqiptar dhe motivet shqiptare.
- c) Ç’është Ikona? Çfarë dini mbi përmbajtjen dhe rregullat dhe teknikën e realizimit të saj?

Teza 15

- a) Çfarë dini mbi Pikturën murale meksikane të Diego Riveras e Daniele Orozcos, dhe qasjen e tyre politike / Flisni mbi artistin modern Marc Chagall dhe mbi veprat monumentale të tij.
- b) Kur u shfaq metoda e “Realizmit Socialist” në Shqipëri? Çfarë tiparesh shfaqte kjo metodë? Komentoni ndonjë vepër tipike të Realizmit socialist shqiptar.
- c) A mund të përcaktoni disa teknika të pikturës së aplikuar nëse janë të përshtatshme për interior apo eksterier?

Bibliografi

- Ernst H. Gombrich, **Historia e Artit**, (1996).
- Ermir Hoxha, **Historia e Artit Shqiptar 1858- 2000**, (2019)
- Ermir Hoxha, **Historia e Artit në Shqipëri nga Prehistoria në Shek XIX**, (2020)
- Rozela Dhimgjini, **Momente të Historisë së Artit nga Rilindja deri në shek. XX**, (2016).
- **Internet**: List of art movements.